



**BASHKIA  
REPUBLICANË E TIRANËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr. 129 , datë 28.09.2020**

**“PËR  
DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR 12 (DYMBËDHJETË) FAMILJE QË KANË  
PËSUAR DËME NDËRTIMORE DHE NË ORENDI/ PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE SI  
PASOJË E ZJARRIT, PËRMBYTJES DHE TËRMETIT”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Kreut III, pika 1, shkronja “ë”, të Vendimit nr. 329, datë 16.05.2012, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Vendimit nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të akordojë ndihmën financiare prej 8,142, 226.5 (tetë milionë e njëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e njëzet e gjashtë, pikë pesë) lekë për 12 (dymbëdhjetë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake, si pasojë e zjarrit, përmbytjes dhe tërmetit, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës 1, të këtij vendimi, të përballohen nga fondi i emergjencave i parashikuar në Programin e Mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtja civile (Kod Programi 03280) të Aparatit të Bashkisë në artikullin 606 në buxhetin e vitit 2020 të Bashkisë së Tiranës.
3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**TONI GOGU**